

Imazhi përtej kuadrit apo ekstaza e pikturës

Agim Sulaj, Çmimi ndërkombëtar "Galantara" për grafikën satirike

LUCIO DEL GOBBO

Pikërisht kështu: Agim Sulaj nisat nga një vegim ekstaze i pikturës, edhe pse jo i përhumbur. Zgjedh nga katalogu i madh i historisë së tij ato faqe ku realizmi gjen në vetvete, në aftësinë e tij përngjasuese e shprehëse, ekstazën e gjenialitetit. Fiamingët, Karavaxho, realistët e mëdhenj spanjollë, piktura napoletane e 1800-s e shtyjnë të shkojë deri aty ku të tjerë para tij kanë vajtur dhe kanë shijuar ethet e zotërimin të realitetit. Me anë të pikturës, syri dhe zemra mund të çohen drejt shpirtit të realitetit dhe ta rindërtojnë atë ose, thënë më mirë, ta riprodhojnë, me përvuajtjen dhe ekstazën e demiurgut. Kjo është orvatja prej nga nisat e vijon denjësisht Agim Sulaj, imazhi i tij zë e "flet": një tejrealizëm strategjik e drejton për nga mendimi dhe ndjenja. Po të vëresh dritat, nuk janë drita reale, një "teknik" fantazmë i përqendron aty ku duhen ose i shpërndan duke krijuar një qashtësi surreale e metafizike, të përngjashme me ëndrën, kujtimin a poezinë. Por në gjithë këtë nuk ka komedi, as spektakël, as teatralitet patetik, por vërtetësi të prehur te shpirti, të futur në botën e brendshme. T'i besojë imazhit përkujtimoren e emocioneve të jetuara, të parafytyruara apo të ëndërruara; të dëgjojë heshtjet, meloditë e lehta, aromat; të rizgjojë fëmijërinë nëpërmjet objekteve dhe sendeve tashmë të lëna në harresë; të jetojë boshllëkun që koha lë pas vetes pakthyeshmërisht - janë bash këto elementet më të shpeshta, më të pranishme në poetikën e Agim Sulajt. Por jo vetëm. Ai i beson imazhit edhe më tepër, ndaj është pikërisht kjo aftësi e të endurit "përtej kuadrit" që i fal autorit dhe veprës së tij idenë e një plotësie dhe gjallërie të pazakontë. E kam fjalën për interesin ndaj satirës, që përveç qëllimit parësor moral kërkon edhe angazhimin në një pjesëmarrje civile: shërbimin e tij si qytetar i botës. Sulaj teknikisht shprehet nëpërmjet pikturës në vaj, por shpesh edhe me dëshirë hidhet në grafikë, ku teknika e tij është po aq e mrekullueshme. Duket gati sikur



aftësia e jashtëzakonshme e artistit viziv ka nevojë për më tepër hapësirë për t'u shprehur tërësisht. Janë dy botë brenda tij që e përpunin drejt këtyre dy zhanreve. Pikturës i fal pjesën më të mëvetëshme të shpirtit të tij, duke nxjerrë në sipërfaqe imazhe të kujtesës, për të ushqyer kësaj një ndjeshmëri shpirtërore dhe poetike. Ndërsa grafikës, me një formë satirike, por edhe me imazhe dramatike që gërvishin e shkundin, parapëlqen t'i besojë reflektimit ndaj çështjes sociale, ndaj problematikave që gëlojnë realitetin e sotëm, si: mbrojtja ekologjike, përdorimi i ekuilibruar i natyrës, denoncimi i konsumizmit, si dhe reflektimi ndaj fenomeneve që përjetojmë të gjithë, si emigracioni, bashkimi në Europë, globalizimi etj. Këto tema i kanë dhënë emër jo vetëm në rrethet e ngushta artistike apo satirike; çmimet e shumta që ka fituar janë tregues të kësaj fame. Kështu pra, dy botë e dy mënyra që

përkojnë me dy kohësi: me të përjetshmen dhe me të tashmen. Por edhe me dy këndvështrime: këndvështrimin relativ dhe atë absolut. Natyrisht që ndarja nuk kyçet me shul (termin e kemi huazuar nga një pikturë e famshme e autorit), por komunikon në mënyrë të tillë që lejon njëren pjesë të futet te tjetra. E pikërisht nga kjo aftësi kompensimi, prodhimtaria artistike e Sulajt fiton unitet dhe plotësi. Në këtë këndvështrim mund të shihet vlera dyfishe shprehëse, si dhe cilësia piktoreske e veprës që paraqet pemën e çrrënjësuar me njeriun që e shtyn duke i qëndruar përsipër; apo njeriu me valixhen e kujtesës të boshatisur e të shpartalluar në mënyrë dramatike! Një artist aspak i ndarë në dysh, por koherent, i cili pavarësisht nga teknikat që përdor, di të shprehë një ndjesi morale e poetike të thellë, të njësuar e të njëkohëzuar, t'u japë jetë herë pas here ndjenjës dhe zemërimin.

Disa vëzhgues kanë vërejtur në veprën e Sulajt një prirje dekadente, e cila përkon me gjendjen që atdheu i autorit, Shqipëria, po përjeton në këtë kohë. Por edhe lidhur me këtë duhet nënvizuar pozitiviteti i mesazhit që ai hedh; çdo imazh i tij është fryt i një përsiatjeje që dëshmon një bashkëmendësi intime sociale, e cila përshtatet jo me një vend, por me botën; jo me kronikën, por me historinë universale; një ankh që mund ta provojë vetëm ai që merr pjesë thellësisht dhe qytetarisht në jetë, duke u angazhuar me mjetet e veta për t'i dhënë zgjidhje. Agim Sulaj mund të quhet një satirik "pozitiv", por edhe "i lig" kur duhet ose thënë më mirë "i rreptë" kur dëfton sëmundjet që mendojnë shoqërinë.



AGIM SULAJ

E ka dashuruar pikturën që në moshë të njomë dhe është rritur duke u sjellë me laps e penel në dorë përqark rrugëve dhe shëtitorës pranë detit të qytetit të tij.

Është diplomuar në Akademinë e Arteve të Bukura të Universitetit të Tiranës më 1985-n.

Gjatë viteve të universitetit, si dhe pas diplomës, ka bashkëpunuar me revistën politiko-humoristike *Hosteni*, duke hyrë kështu në botën e humorit dhe satirës. Me kalimin e viteve, grafika humoriste u bë edhe binari i dytë i rëndësishëm i karrierës së tij artistike.

Në 1993-shin hapi ekspozitën e parë personale në Itali, pranë Meeting-ut në Rimini, me veprat e botuara në revistën *Hosteni*, edhe pse të bëra nën regjimin komunist në Shqipëri.

Që nga ajo kohë është vendosur në Rimini me të shoqen dhe dy fëmijët dhe vazhdon të merret me pikturë tejrealiste dhe grafikë satiro-humoristike, të karakterizuar gjithnjë nga stili vetjak.

Në pikturat e tij dhe në përgjithësi në të gjitha veprat, ndihet malli për fëmijërinë dhe bukuritë e tokës së vet; në satirë peneli i tij është i ndjeshëm ndaj problemeve më të mprehta politike e sociale të ditëve tona. Ekspozon pranë Galerisë së Arteve Forni të Bolonjës, ku pikturat e tij janë ekspozuar bashkë me ato të artistëve me famë ndërkombëtare, si të Giacometri-t, Balthus-it, Mitoraj-it, De Chirico-s, Odd Nerdrum-it. Gjithashtu merr pjesë me sukses në konkurse të shumta ndërkombëtare të vizatimeve dhe grafikave, ku ka fituar çmime dhe vende nderi, si "Çmimin e Ekselencës të Kombeve të Bashkuara" më 2009-n në Nju Jork, "Çmimin e Sallonit Ndërkombëtar të Viarden-it" në Luksemburg, "Çmimin ndërkombëtar në Tourcoirn" në Francë, si dhe në Spanjë, Itali, Belgjikë, Turqi, Portugali, Iran, Gjermani, Kosovë.

Piktura për Agim Sulajn është një vend argëtimi i gëzueshëm, ku koha nuk mjafton kurrë.